

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 27 shkurt 2012

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 27 shkurt 2012

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E PROKURORISË PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË
SHUMICËS PËR MOSPRANIMIN E DOKUMENTIT TË RREGULLËS 65TER NUMËR
03003 OSE NDRYSHE PËR LEJIMIN E APELIMIT TË VENDIMIT TË SHUMICËS ME
MENDIMIN PJESËRISHT MOSPAJTUES TË GJYKATËSIT DELVOIE**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Mocion i Prokurorisë për rishikimin e vendimit të shumicës për mospranimin e dokumentit të Rregullës 65ter numër 03003 ose ndryshe për lejimin e apelimit të vendimit të shumicës” paraqitur publikisht prej Zyrës së Prokurorit (“Prokuroria”) më 13 tetor 2011 (“Mocioni”), dhe nxjerr vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 27 qershor 2011, Prokuroria paraqiti konfidencialisht “Mocion i Prokurorisë për pranimin e provave sipas Rregullës 92ter”, ku, midis të tjerash, kërkoi pranimin si provë të ditarit të shkruar me shkrim dore që pretendohet se është i Idriz Balajt (“Ditari”), si provë shoqëruese e deklaratës së propozuar me shkrim të dëshmitarit të Prokurorisë Mehmet Togal. Më 23 gusht 2011, Dhoma nxori “Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave sipas Rregullës 92ter”, në të cilin shtyu vendimin e saj për pranimin e Ditarit deri në dëgjimin e dëshmisë së Mehmet Togal-it.¹ Më 28 shtator 2011, Dhoma dëgjoi dëshminë e Mehmet Togal-it dhe pas parashtrimeve të mëtejshme të Palëve,² Shumica, me përjashtim të mendimit mospajtues të Gjykatësit Delvoie, refuzoi pranimin e Ditarit.³ Më 6 tetor 2011, Dhoma paraqiti arsyetimin me shkrim të Vendimit të Shumicës për mospranimin e dokumentit (“Vendimi i Apeluar”).⁴

2. Prokuroria e paraqiti këtë Mocion më 13 tetor 2011 ku i kërkoi Dhomës rishikimin e Vendimit për mospranimin e Ditarit, apo ndryshe, miratimin e kërkesës për leje për apelim të ndërkohshëm të Vendimit. Më 27 tetor 2011, Haradinaj dhe Balaj

¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave sipas Rregullës 92ter, lëshuar konfidencialisht më 23 gusht 2011, para. 47.

² *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, T. 1349-1351 (Balaj), 1351-1353 (Haradinaj), 1353-1356 (Prokuroria).

³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, T. 1356.

⁴ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Arsyetim i Vendimit për mospranimin e Dokumentit të Rregullës 65ter numër 03003, paraqitur publikisht më 6 tetor 2011 (“Arsyetimi me Shkrim”). Në kuadër të këtij vendimi, Dhoma do t’i referohet vendimit të saj gojor të datës 28 shtator 2011 dhe Arsyetimit me Shkrim së bashku si “Vendimi” apo “Vendimi i Apeluar”.

paraqitën konfidencialisht përgjigjet e tyre ku i kërkuan Dhomës që të hidhte poshtë Mocionin (përkatesisht “Përgjigja e Haradinajt” dhe “Përgjigja e Balajt”).⁵

II. PARASHTRIME

3. Prokuroria parashtroi se arsyetimi i Shumicës është dukshëm i gabuar, duke qenë se, në kundërshtim me Vendimin e Apeluar, ekzistojnë prova të mjaftueshme për të konkluduar se Ditari është *prima facie* i besueshëm dhe rrjedhimisht i pranueshëm sipas Rregullës 89 (C) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”). Në veçanti parashtrohet se nëpërmjet arsytimit të gabuar se Ditari “duhet të jetë në pamje të parë autentik për të qenë *prima facie* i besueshëm,”⁶ Shumica i dha rëndësi të tepruar vetë dokumentit dhe nuk i shqyrtoi siç duhet rrethanat e tjera.⁷ Prokuroria parashtroi se megjithëse karakteristikat kryesore që vënë në dukje *prima facie* autenticitetin e një prove mund të jenë të rëndësishme në përcaktimin e besueshmërisë së provës, autenticiteti në vetvete nuk ka të bëjë vetëm me autorësinë e dokumentit por edhe origjina ose autorësia e dokumentit janë ashtu siç pretendohet.⁸

4. Prokuroria më tej parashtroi se pavarësisht nëse Balaj është ose nuk është autori i Ditarit, tërësia e rrethanave nxjerr qartë në pah se sipas standardit *prima facie*, Ditari është i besueshëm për arsye se Balaj është burimi i përmbytjes së Ditarit.⁹ Në mbështetje të parashtrimit të saj, Prokuroria argumenton se Ditari u gjet në dhomën e gjumit të Balajt mbi të njëjtën tavolinë ku ndodhej edhe letërnjoftimi i tij i UÇK-së, se Ditari përmban emrin e tij, vendin dhe datën e lindjes së tij, se shënimet në Ditar janë shkruar nga

⁵ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Përgjigje e Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për rishikimin e Vendimit të Shumicës për mospranimin e dokumentit të Rregullës 65ter numër 03003, ose ndryshe për lejimin e apelimit të vendimit të shumicës, paraqitur publikisht më 27 tetor 2011 (“Përgjigja e Haradinajt”). Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kundërshtim i Idriz Balajt ndaj rishikimit të Vendimit për mospranimin e dokumentit të Rregullës 65ter numër 03003 apo miratimit të lejes për apelim të ndërkohshëm të vendimit, paraqitur publikisht më 27 tetor 2011 (Përgjigja e Balajt”).

⁶ Mocioni, para. 1, 4.

⁷ Mocioni, para. 4.

⁸ Mocioni, para. 4, citon Prokurori k. Përliqit, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.16, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Jadranko Përliqit të Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes së Përliqit për Rishikimin e Vendimit në lidhje me pranimin e provave dokumentare, paraqitur publikisht më 3 nëntor 2009 (“Vendimi i Apelit Përliq i datës 3 nëntor 2009”), para. 34.

⁹ Mocioni, para. 5.

këndvështrimi i Balajt, dhe se autori i referohet vetes me komandant i “njësisë speciale”, gjë që përkon me rolin e pretenduar të Balajt.¹⁰ Prokuroria parashtrohet se Dhoma e Apelit ka lënë në fuqi një vendim për pranimin e provave në rrethana të ngjashme dhe i referohet në veçanti Vendimit të Dhomës së Apelit në çështjen *Prokurori k. Delalijit dhe të tjerëve*.¹¹

5. Gjithashtu, Prokuroria i referohet përmbajtjes së Ditarit dhe argumenton se disa pjesë të tij përputhen me provat që ka pranuar Dhoma.¹² Së fundi, Prokuroria parashtrohet se përmbajtja e Ditarit së bashku me prova të tjera janë të rëndësishme për vërtetimin e lidhjes së ngushtë midis të Akuzuarve, pikë debati midis Palëve në këtë proces, dhe rrjedhimisht pretendon se mosmiratimi i kërkesës së saj për rishikimin e Vendimit të Shumicës do të shkaktojë padrejtësi meqenëse Dhoma do të privohet prej një prove të rëndësishme dhe me vlerë provuese për çështjet e debatuar nga Palët.¹³

6. Në mbështetje të kërkesës së saj që ndryshe Dhoma të miratojë kërkesën për leje për apelim të ndërkohshëm të Vendimit të Shumicës, Prokuroria parashtrohet se Vendimi ndikon ndjeshëm në realizimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë dhe në rezultatin e këtij procesi gjyqësor, dhe se zgjidhja e menjëhershme e kësaj çështjeje nga Dhoma e Apelit mund ta ndihmojë thelbësisht procesin. Prokuroria pretendon se Dhoma zbatoi gabimisht kriterin *prima facie* në përcaktimin e pranueshmërisë së Ditarit, që sjell në vëmendje një aspekt të rëndësishëm në lidhje me kriterin e përshtatshëm të vlefshëm për pranimin e provave sipas Rregullës 89 (C) të Rregullores.¹⁴ Prokuroria parashtrohet se për të shmangur çdo paqartësi është e nevojshme që parimet në lidhje me pranueshmërinë e provave të zbatohen në mënyrë të qartë, koherente dhe të drejtë, dhe se për këtë arsye Vendimi cenon realizimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.¹⁵ Prokuroria më tej argumenton se Vendimi i Dhomës në mënyrë të padrejtë kufizon paraqitjen e provave të

¹⁰ Mocioni, para. 5.

¹¹ Mocioni, para. 6, citon *Prokurori k. Delalijit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-96-21-AR73.2, Vendim mbi Kërkesën e të Akuzuarit Zejnil Delalij për leje për të apeluar Vendimin e Dhomës Gjyqësore të datës 19 janar 1998 në lidhje me pranimin e provave, lëshuar publikisht më 4 mars 1998.

¹² Mocioni, para. 7.

¹³ Mocioni, para. 8.

¹⁴ Mocioni, para. 11.

¹⁵ Mocioni, para. 11, 12.

Prokurorisë, duke mos pranuar prova të rëndësishme për rolin e Balajt në lidhje me çështjet e debatuar midis palëve.¹⁶ Ajo pretendon se në këtë mënyrë Dhoma privohet nga prova të cilat mund t'a ndihmojnë në analizat e saj, dhe se kjo mund të ndikojë në rezultatin e rigjykit.¹⁷ Prokuroria më tej argumenton se zgjidhja e menjëhershme e kësaj çështjeje nga Dhoma e Apelit mund ta ndihmojë thelbësisht procesin, për arsye se, për mendimin e saj, formulimi i standardeve të sakta ligjore në lidhje me kushtet e pranimi të provave nga Dhoma e Apelit në një fazë më të hershme do të mundësojë zgjidhje më efikase të çështjeve të parashtruara në Vendim.¹⁸ Sipas Prokurorisë, çështjet që trajton Vendimi mund të zgjidhen në mënyrë më efikase në këtë fazë të procesit, për arsye se mospranimi i Ditarit do t'i pamundësojë Dhomës që ta vlerësojë atë në kuadër të tërësisë së provave, dhe Dhoma është në pozitë më të mirë për të vlerësuar tërësinë e provave krahasuar me Dhomën e Apelit, nëqoftëse kjo e fundit më vonë do të gjejë gabim.¹⁹

7. Haradinaj parashtron se të dy kërkesat e Prokurorisë duhet të refuzohen. Ai parashtron se Prokuroria nuk ka paraqitur bazën e duhur që do t'i mundësonte Dhomës të ushtronte kompetencat e saj të jashtëzakonshme për rishikimin e Vendimit. Për mendimin e tij, Prokuroria nuk vërtetoi se arsyetimi apo gjykimi i paraqitur në Vendim është dukshëm i gabuar. Në veçanti Haradinaj argumenton se fakti që informacioni i paraqitur në dokument mund të përputhet me prova të tjera është vetëm një faktor që mund të merret parasysh për të përcaktuar nëse është plotësuar kriteri i besueshmërisë *prima facie*.²⁰ Ai parashtron se Dhoma e ka marrë parasysh këtë faktor së bashku me të gjithë faktorët e tjerë të rëndësishëm, duke përfshirë mungesën e provave në lidhje me dorëshkrimin e ditarit, burimin e informacionit dhe mënyrën e komunikimit midis burimit dhe autorit.²¹ Sipas Haradinajt, Prokuroria thjesht po përsërit të njëjtat argumente që paraqiti në mbështetje të Mocionit të saj për pranimin e Ditarit, në veçanti argumentin se informacioni që përmban dokumenti duhet të shqyrtohet së bashku me prova të tjera të

¹⁶ Mocioni, para. 13.

¹⁷ Mocioni, para. 13.

¹⁸ Mocioni, para. 14, 15.

¹⁹ Mocioni, para. 15.

²⁰ Përgjigjja e Haradinajt, para. 13, citon *Prokurori k. Ntahobali-t*, Lënda nr. ICTR-98-42-T, Vendim mbi Mocionin e Ntahobali-t për pranimin e dokumenteve si provë, 30 shtator 2008, para. 25.

²¹ Përgjigjja e Haradinajt, para. 13.

pranuara në rigjykim dhe se besueshmëria e dokumentit vërtetohet nga fakti se “Balaj është burimi i informacionit”.²² Haradinaj pretendon se Mocioni nuk merr parasysh jurisprudencën sipas të cilës kërkesat për rishikim të vendimeve nuk duhet të shndërrohen në mekanizëm për korrigjimin e mangësive të mocioneve dhe parashtrimeve të palëve.²³ Ai më tej parashtrohet se rrethanat faktike në këtë proces në asnjë mënyrë nuk mund të krahasohen me vendimin e Dhomës së Apelit në çështjen *Delaliq* të cilit i referohet Prokuroria, për arsye se në atë çështje autorët e dokumenteve ishin të njohur dhe problemi kyç ishte nëse ishte vërtetuar sistemi i përcjelljes së dokumenteve për të provuar besueshmërinë e tyre dhe lidhjen e tyre me të akuzuarin.²⁴

8. Në përgjigjen e tij ndaj kërkesës alternative të Prokurorisë për leje për vërtetim, Haradinaj parashtrohet se Prokuroria nuk ka identifikuar ndonjë çështje që do të ndikonte ndjeshëm në realizimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë apo në rezultatin e gjykimit.²⁵ Ai parashtrohet se Prokuroria nuk ka provuar se ka ndonjë gabim ligjor në Vendim, dhe se fakti që ajo nuk pajtohet me mënyrën se si Shumica zbaton parimet ligjore në lidhje me rrethanat e veçanta faktike nuk ngre ndonjë shqetësim të përgjithshëm apo çështje të rëndësishme për pjesën e mbetur të gjykimit.²⁶ Sipas tij, Prokuroria nuk e ka përmbushur kushtin e dytë të Rregullës 73(B) meqenëse Palët do të kenë mundësi të diskutojnë në sallën gjyqësore pranueshmërinë e dokumenteve gjatë paraqitjes së tyre si provë në rigjykim dhe për këtë arsye argumenti i Prokurorisë se zgjidhja e menjëhershme e çështjes nga Dhoma e Apelit do të parandalonte çdo diskutim të mëtejshëm në gjyq është i gabuar.²⁷

9. Balaj kundërshton të dy kërkesat e paraqitura në Mocion. Në lidhje me kërkesën për rishikim të Vendimit, ai parashtrohet se argumenti i Prokurorisë se Dhoma bëri gabim ligjor kur arsyetoi se Ditari “duhet të jetë në pamje të parë autentik për të qenë *prima facie* i besueshëm” përjashton rrethanat faktike në lidhje me dokumentin konkret. Për

²² Përgjigjja e Haradinajt, para. 4, 11, 12, 13, 14.

²³ Përgjigjja e Haradinajt, para. 13.

²⁴ Përgjigjja e Haradinajt, para. 14.

²⁵ Përgjigjja e Haradinajt, para. 17.

²⁶ Përgjigjja e Haradinajt, para. 17, 18.

²⁷ Përgjigjja e Haradinajt, para. 19.

mendimin e tij, në shikim të parë duket se Ditari është shkruar nga më shumë persona, duke qenë se ka më shumë se një shkrim dore dhe asnjë prej këtyre shkrimeve nuk është identifikuar se i kujt është, dhe në të Balaj përmendet në vetën e parë dhe të tretë.²⁸ Ai më tej parashtrohet se Shumica gjykoi drejtë se dokumenti në shikim të parë nuk zbulon burimin e informacionit të paraqitur në të apo mënyrën e komunikimit midis burimit të informacionit dhe autorit.²⁹ Për më tepër, sipas Balajt, Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë se Balaj me të vërtetë është burimi i informacionit të paraqitur në Ditar, ashtu siç pretendon ajo.³⁰ Balaj parashtrohet se Mehmet Togal-i, dëshmitari përmes të cilit Prokuroria u përpoq të paraqiste Ditarin si provë materiale, nuk ishte në gjendje të dëshmonte në lidhje me përmbajtjen e Ditarit ku përshkruhen ngjarje dhe takime, të cilat, po qe se do të pranohen si të vërteta, ishin të njohura për persona të tjerë dhe jo Balajn.³¹ Balaj më tej parashtrohet se mbështetja e Prokurorisë në vendimin e Dhomës së Apelit në çështjen *Delaliq* është plotësisht e pabazë meqenëse problemi në atë çështje ishte nëse ishte bërë vërtetimi i duhur i regjistrimit të biznesit që përmbante të dhëna për ecurinë e përditshme dhe fushëveprimin e një biznesi që kishte lidhje me të akuzuarin, dhe nëse ishte provuar sistemi i përcjelljes së dokumenteve.³²

10. Balaj më tej parashtrohet se kërkesa e Prokurorisë për leje për apelim të vendimit duhet të hidhet poshtë për arsye se ajo bazohet në supozimin e gabuar se Shumica zbatoi standardin e gabuar ligjor kur refuzoi pranimin e Ditarit si provë. Në veçanti ai parashtrohet se Prokuroria nuk identifikoi asnjë arsye që do të provonte ekzistencën e ndonjë paqartësie në lidhje me kriteret ligjore për pranimin e provave në rigjykim. Ai gjithashtu argumenton se një vendim i Dhomës së Apelit mbi këtë çështje nuk do ndihmonte thelbësisht procesin, për arsye se nuk është provuar nëse Shumica zbatoi standardin e gabuar ligjor.³³

²⁸ Përgjigjja e Balajt, para. 8, 9, 10.

²⁹ Përgjigjja e Balajt, para. 11.

³⁰ Përgjigjja e Balajt, para. 13, 14.

³¹ Përgjigjja e Balajt, para. 14, 15, 16, 17.

³² Përgjigjja e Balajt, para. 19-23.

³³ Përgjigjja e Balajt, para. 29-35.

III. LIGJI PËRKATËS

11. Një Dhomë gëzon kompetenca të “vetvetishme” për rishikimin e vendimeve të mëparshme.³⁴ Në mënyrë që kërkesa për rishikimin e një vendimi të jetë e suksesshme, paraqitësi i kërkesës “duhet ta bindë Dhomën Gjyqësore se arsyetimi [në vendimin e apeluar] është dukshëm i gabuar, apo se ekzistojnë rrethana të veçanta që përligjin rishikimin e vendimit për të shmangur çdo padrejtësi”.³⁵ “Rrethanat e veçanta” mund të përfshijnë fakte apo argumente të reja që kanë dalë pas daljes së vendimit të mëparshëm.³⁶ Sidoqoftë paraqitësi i kërkesës duhet të vërtetojë se në çfarë mënyre faktet apo argumentet e reja që ka paraqitur në kërkesën për rishikim përligjin rishikimin e një vendimi:³⁷ paraqitësi i kërkesës ka detyrimin të vërtetojë se Dhoma ka gabuar dukshëm

³⁴ *Prokurori k. Muciqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-96-21 *Abis*, Vendim mbi Apelimin e Dënimit, 8 prill 2003 (“Vendim mbi Apelimin e Dënimit *Muciq*”), para. 49; *Prokurori k. Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-A, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për rishikim, 16 korrik 2004, (Vendimi *Galiq* i datës 16 korrik 2004”); *Prokurori k. Popoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-88-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për leje për apelim të vendimit për pranimin e provave me shkrim sipas Rregullës 92bis, 19 tetor 2006, (“Vendimi *Popoviq* i datës 19 tetor 2006”); *Prokurori k. Sheshelit*, Lënda Nr. IT-03-67-T, Vendim mbi kërkesën e Prokurorisë për rishikim ose ndryshe për leje për apelim të vendimit të datës 22 dhjetor 2010 në lidhje me Dëshmitarin VS-037, 25 korrik 2011 (Vendimi *Sheshel* i datës 25 korrik 2011”), para. 34. *Prokurori k. Miqo Stanishiqit dhe Stojan Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-PT, Vendim për Miratimin e Kërkesës së Prokurorisë për rishikim të pjesshëm të Vendimit të 21 korrikut 2011, 22 gusht 2011 (“Vendimi *Stanishiq dhe Zhuplanin* i datës 22 gusht 2011”), para. 15.

³⁵ *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.16, Vendim mbi Apelin e ndërkohshëm të Jadranko Përliqit të Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes së Përliqit për rishikimin e Vendimit mbi pranimin e provave dokumentare, 3 nëntor 2009 (“Vendimi i Apelit *Përliq* i datës 3 nëntor 2009”), para. 18; Vendimi *Galiq* i datës 16 korrik 2004; *Prokurori k. Haxhihasanoviqit dhe Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A, Vendim mbi Mocionin e apellesit për rishikim dhe zgjatje të afateve kohore, 30 janar 2007 (Vendimi i Apelit *Haxhihasanoviq* i datës 30 janar 2007”), para. 9; Vendim mbi Apelimin e Dënimit *Muciq*, para. 49; *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-T, Vendim mbi Kërkesën për rishikim dhe për leje për apelim të Vendimit mbi pranimin e deklaratës së Jadranko Përliqit, 8 tetor 2007, para. 11; Vendimi *Sheshel* i datës 25 korrik 2011, para. 37; *Niyitegeka k. Prokurorit*, Lënda Nr. ICTR-96-14-A, Vendim mbi Mocionin tejet urgjent të Mbrojtjes për rishikim të Vendimit të datës 16 dhjetor 2003, 19 dhjetor 2003, f. 3.

³⁶ Vendimi *Popoviq* i datës 19 tetor 2006, f. 4; *Prokurori k. Perishiqit*, Lënda Nr. IT-04-81-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për rishikim të vendimit në lidhje me dokumentin e pranuar *Proprio Motu*, 28 shkurt 2011, para. 12; Vendimi *Stanishiq dhe Zhuplanin* i datës 22 gusht 2011, para. 15; *Prokurori k. Semanza-s*, Lënda Nr. ICTR-97-20-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për rishikim të Vendimit për refuzimin e lejes për thirrje të dëshmitarëve gjatë paraqitjes së kundërprovave të Mbrojtjes, 9 maj 2002, para. 8; Vendimi i Apelit *Përliq* i datës 3 nëntor 2009, para. 18; Vendimi *Galiq* i datës 16 korrik 2004, f. 2.

³⁷ Vendimi i Apelit *Përliq* i datës 3 nëntor 2009, para. 18; Vendimi *Galiq* i datës 16 korrik 2004, f. 2; Vendimi i Apelit *Haxhihasanoviq* i datës 30 janar 2007, para. 9; *Prokurori k. Millosheviqit*, Lëndët Nr. IT-99-37-AR73. ZIT-01-50-AR73 dhe IT-01-51-AR73, Arsyetim i Vendimit në lidhje me apelimin e ndërkohshëm të Prokurorisë për shkak të mosurdhërimit të Bashkimit të Aktakuzave, 18 prill 2002, para. 4, 5.

apo se rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur çdo padrejtësi.³⁸ Dhoma Gjyqësore mund të refuzojë një kërkesë për rishikim në rast se gjatë paraqitjes së informacionit të ri, paraqitësi i kërkesës nuk arrin të vërtetojë se informacioni i ri përbën rrethanë të re që justifikon rishikimin e vendimit prej Dhomës.³⁹

12. Parimi i përfundimësisë së një vendimi kushtëzon se kompetenca për rishikimin e një vendimi të mëparshëm duhet të ushtrohet me masë.⁴⁰ Palët nuk duhet të përdorin kërkesat për rishikim si “mekanizëm [...] për korrigjimin e mangësive në mocionet e tyre apo për të kundërshtuar një vendim të Dhomës dhe anashkaluar rregullat e procedurës në lidhje me lejen për apelimin e vendimeve të Dhomave Gjyqësore”.⁴¹ Për shkak të numrit gjithnjë e më të madh të kërkesave për rishikim të vendimeve, Dhoma Gjyqësore III në çështjen *Përliq dhe të tjerët* kufizoi të drejtat e palëve për paraqitjen e mocioneve të tilla.⁴² Një prej këtyre kufizimeve ishte refuzimi i kërkesave për rishikim që janë rezultat i gabimeve të vetë palëve.⁴³

13. Sipas Rregullës 73(B) të Rregullores, vendimet në lidhje me të gjitha mocionet nuk i nënshtrohen apelit të ndërkohshëm, me përjashtim të rastit kur Dhoma Gjyqësore ka miratuar leje. Qëllimi i Rregullës 73(B) është parandalimi i kërkesave për leje për apelim të ndërkohshëm të vendimeve të Dhomës, në rast se nuk janë përmbushur kushtet e parashtruara në këtë Rregull, por edhe atëherë Dhoma Gjyqësore gëzon kompetenca për miratimin ose mosmiratimin e lejes.⁴⁴ Sipas Rregullës 73(B), Dhoma Gjyqësore mund të miratojë leje për apelim të ndërkohshëm të një vendimi nëse janë përmbushur dy kriteret në vijim: (a) nëqoftëse vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte në mënyrë të dukshme kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit, dhe (b) një

³⁸ *Prokurori k. Gjorgjeviqit*, Lënda Nr. IT-05-87ë1-T, Vendim mbi Mocionin e Vllastimir Gjorgjeviqit për rishikim apo leje për apelim në lidhje me ekspertin e propozuar z. Aleksandar Paviq, 23 prill, 2010, para. 6.

³⁹ Vendimi i Apelit *Përliq* i datës 3 nëntor 2009, para. 19.

⁴⁰ Vendimi *Semanza*, para. 8.

⁴¹ *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74, Vendim në lidhje me Kërkesat e Palëve për rishikim të Vendimeve të Dhomës, 2 prill 2009, (“Vendimi *Përliq* i datës 2 prill 2009”), f. 3.

⁴² Vendimi *Përliq* i datës 2 prill 2009, f. 3.

⁴³ Vendimi *Përliq* i datës 2 prill 2009, f. 3, 4.

⁴⁴ *Prokurori k. Miqo Stanishiqit dhe Stojan Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-PT, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për leje për apelim, lëshuar publikisht më 22 prill 2009 (“Vendimi *Stanishiq dhe Zhuplanin*”), para. 11; *Prokurori k. Pavle Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për leje për apelim, 17 qershor 2004, para.2.

vendim i menjëhershëm nga ana e Dhomës së Apelit mund, për mendimin e Dhomës Gjyqësore, ta ndihmojë thelbësisht procesin. Kërkesa për leje nuk ka të bëjë me arsyetimin e drejtë apo të gabuar të një vendimi, meqenëse kjo i takon apelit, qoftë ai i ndërkohshëm apo pas nxjerrjes së aktgjykimit.⁴⁵

IV. DISKUTIM

A. Kërkesa e Prokurorisë për rishikim

14. Prokuroria parashtroi se arsyetimi i Shumicës ishte dukshëm i gabuar për arsye se ajo i kushtoi rëndësi të tepruar dokumentit si të tillë dhe nuk i shqyrtoi siç duhet rrethanat e tjera, tërësia e të cilave, për mendimin e Prokurorisë, provon besueshmërinë *prima facie* të Ditarit, duke qenë se Balaj është burimi i informacionit të paraqitur në Ditar. Prokuroria parashtroi se Shumica gaboi kur gjykoi se Ditari “duhet të jetë në pamje të parë autentik për të qenë *prima facie* i besueshëm”, gjë që tregon se Dhoma i kushtoi “rëndësi të tepruar” dokumentit si të tillë.⁴⁶

15. Shumica vë në dukje se në Vendimin e Apeluar, ajo në veçanti shqyrtoi argumentet e Prokurorisë në mbështetje të pretendimit të saj se Balaj është burimi i informacionit të paraqitur në Ditar, respektivisht se Ditari mbante emrin, datën dhe vendin e lindjes së Balajt, se ishte shkruar nga këndvështrimi i Balajt dhe se ishte gjetur në dhomën e tij të gjumit.⁴⁷ Këta faktorë Shumica i shqyrtoi bashkërisht me faktorë të tjerë që anonin kundër pranimi të Ditarit, gjegjësisht se nuk ishte provuar autorësia e Ditarit, se nuk ishte i qartë burimi i informacionit të paraqitur në Ditar dhe mënyra e komunikimit midis autorit dhe burimit të informacionit.⁴⁸ Në kundërshtim me

⁴⁵ Vendimi *Stanishiq dhe Zhuplanin*, para. 11; *Prokurori k. Slobodan Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për leje për apelim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin e Prokurorisë për Procedurë *Voir Dire*, 20 qershor 2005, para. 4; *Prokurori k. Ivan Çermakut dhe Mlladen Markaçit*; *Prokurori k. Ante Gotovinës*, Lëndët Nr. IT-03-73-PT, IT-01-45-PT, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për leje për apelim të Vendimit mbi Mocionin Përmbledhës të Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës dhe për Bashkim të Aktakuzave, 14 gusht 2006, para. 10; *Prokurori k. Millan Millutinoviçit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për leje për apelim të ndërkohshëm të Vendimit të Rregullës 98bis, 14 qershor 2007, para. 4.

⁴⁶ Mocioni, para. 4.

⁴⁷ Arsyetimi me Shkrim, para. 9.

⁴⁸ Arsyetimi me Shkrim, para. 9.

parashtrimin e Prokurorisë,⁴⁹ Shumica nuk e shqyrtoi autenticitetin e dokumentit vetëm në prizmin e autorësisë, por mori parasysh edhe argumentet në lidhje me vërtetimin e burimit dhe autorësisë së dokumentit.⁵⁰ Në tërësi, Shumica konkludoi se dokumenti nuk dukej *ex facie* autentik për të plotësuar kriterin e besueshmërisë *prima facie*.

16. Përfundimi i Shumicës ndjek jurisprudencën e Dhomës së Apelit se “në rrethanat e veçanta me të cilat ballafaqohet një Dhomë, karakteristikat kryesore që vënë në dukje *prima facie* autenticitetin e një dokumenti mund të jenë të rëndësishme për përcaktimin e besueshmërisë *prima facie* të dokumentit,⁵¹ dhe një vendim i tillë është brenda kompetencave të Dhomës Gjyqësore sipas Rregullës 89(C).⁵² Prokuroria nuk e kundërshton faktin se faktorët që shqyrtoi Dhoma janë të rëndësishëm për të verifikuar nëse dokumenti i përmbush kriteret e besueshmërisë *prima facie* por thjesht nuk pajtohet me rëndësinë që Shumica u kushtoi disa prej këtyre faktorëve. Për mendimin e Shumicës, Prokuroria nuk ka vërtetuar gabim të dukshëm në arsyetimin e Dhomës.

17. Prokuroria më tej argumenton se për të shmangur çdo padrejtësi, Vendimi i Apeluar duhet të rishikohet për arsye se në të kundërtën, Dhoma nuk do të ketë mundësi të marrë një provë të rëndësishme dhe me vlerë provuese për çështjet e kundërshtuara nga palët. Shumica nuk bindet nga ky argument. Ajo vë në dukje se Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë që do të vërtetonte se autorësinë e Ditarit dhe burimin e informacionit të paraqitur në të. Prokuroria parashtroi se çështjet e përshkruara në Ditar konfirmohen nga prova të tjera që ka marrë Dhoma. Megjithatë, siç gjykoi Dhoma e Apelit, “konfirmimi nuk është kusht, e as garanci për besueshmërinë e një prove.”⁵³ Si përfundim, Shumica nuk është e bindur se rishikimi i Vendimit është i domosdoshëm për të shmangur çdo padrejtësi.

B. Kërkesa e Prokurorisë për leje për apelim

⁴⁹ Mocioni, para. 4.

⁵⁰ Arsyetimi me Shkrim, para. 9.

⁵¹ Vendimi i Apelit *Përliq* i datës 3 nëntor 2009, para. 34.

⁵² *Shih* Vendimi i Apelit *Përliq* i datës 3 nëntor 2009, para. 27.

⁵³ *Prokurori k. Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-A, Aktgjykim, 27 shtator 2007, para. 203.

18. Ndryshe, Prokuroria kërkon që Dhoma të miratojë leje për apelim të Vendimit. Në lidhje me kushtin e parë të Rregullës 73(B), Prokuroria argumenton se Dhoma zbatoi gabimisht standardin e besueshmërisë *prima facie* në lidhje me pranimin e Ditarit si provë, gjë që shkakton paqartësi për sa i përket standardit të duhur për kushtet e pranimin të provave në rigjykim dhe i pamundëson Dhomës marrjen e provave të rëndësishme. Në lidhje me kushtin e dytë të Rregullës 73(B), Prokuroria parashtrohet se një formulim i standardit të duhur ligjor për kushtet e pranimin të provave nga ana e Dhomës së Apelit mund ta ndihmojë thelbësisht procesin.

19. Prokuroria parashtrohet se Vendimi ngre një çështje të rëndësishme lidhur me standardin e duhur ligjor për kushtet e pranimin të provave sipas Rregullës 89(C) dhe argumenton se gjatë rigjyimit është thelbësore që parimet në lidhje me pranueshmërinë e provave të zbatohen në mënyrë të qartë, koherente dhe të drejtë. Dhoma pajtohet se për çdo proces gjyqësor është thelbësore që parimet në lidhje me pranueshmërinë e provave të zbatohen në mënyrë të qartë, koherente dhe të drejtë, por nuk është e bindur se Vendimi krijon problemin e mungesës së koherencës apo vazhdimësisë në lidhje me kushtet e pranimin të provave në këtë rigjykim. Dhoma ka përcaktuar standardin ligjor për pranimin e provave në përputhje me Rregullën 89(C) që në fazën paragjyqësore të këtij procesi⁵⁴ dhe që atëherë e ka zbatuar atë pandryshueshmërisht.⁵⁵ Prokuroria nuk ofron argumente konkrete në lidhje me mungesën e koherencës por vetëm pretendon se Dhoma nuk zbatoi standardin e duhur ligjor në Vendimin e saj. Dhoma vë në dukje se kërkesa për leje ka të bëjë me përmbushjen e kushteve të Rregullës 73(B) dhe jo me arsyetimin e drejtë apo të gabuar të një vendimi, meqenëse kjo i takon apelit, qoftë ai i ndërkohshëm apo pas nxjerrjes së aktgjyimit.⁵⁶ Për këtë arsye, Dhoma nuk është e bindur se argumentet e Prokurorisë përmbushin kushtin e parë të Rregullës 73(B).

⁵⁴ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e transkripteve të dëshmive në vend të dëshmive gojore sipas Rregullës 92bis, 22 korrik 2011.

⁵⁵ *Shih Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave sipas Rregullës 92ter, 23 gusht 2011; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave sipas Rregullës 89(F), 5 shtator 2011.

⁵⁶ *Shih* më lart, para. 10.

20. Dhoma duhet të bindet se janë përmbushur dy kushtet e Rregullës 73(B) përpara se të ushtrojë kompetencat e saj, dhe për këtë arsye hedh poshtë kërkesën e Prokurorisë për leje për apelim.

V. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura dhe bazuar në Rregullat 54, 73(B) dhe 89(C) të Rregullores, Dhoma:

- (1) Me shumicën, me përjashtim të mendimit mospajtues të Gjykatësit Delvoie, **REFUZON** kërkesën e Prokurorisë për rishikim të Vendimit;
- (2) . Njëzëri **REFUZON** kërkesën e Prokurorisë për leje për apelim të Vendimit.

Gjykatësi Delvoie bashkëngjijt mendimin e tij pjesërisht mospajtues.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 27 shkurt 2012.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT DELVOIE

1. Me respekt shpreh mospajtimin tim me vendimin e Shumicës në lidhje me kërkesën e Prokurorisë për rishikimin e Vendimit të Shumicës,¹ të cilit i bashkëlidh mendimin tim mospajtues.² Për mendimin tim, Prokuroria vërtetoi ekzistencën e “arsyetimit të gabuar” në Vendimin e Shumicës që justifikon rishikimin e vendimit për mospranimin e Ditarit si provë materiale sipas Rregullës 89(C).

2. Kujtoj se nga dëshmia e Mehmet Togal-it, Dhoma u bind se Ditari u gjet në dhomën e gjumit të Idriz Balajt, së bashku me letërnjoftimin e tij të UÇK-së, dhe u bind për mënyrën e përcjelljes së këtij dokumenti nga momenti i konfiskimit. Më pas Dhoma ekzaminoi Ditarin dhe provat e tjera shoqëruese për të vërtetuar besueshmërinë dhe rëndësinë e tij *prima facie* në kohën e pranimit.

3. Siç theksohet në mendimin tim mospajtues të mëparshëm, besueshmëria *prima facie* e Ditarit vërtetohet nga faktet në vijim: (i) Ditari u gjet në dhomën e gjumit të Balajt; (ii) ai mban emrin, datën dhe vendin e lindjes së Balajt; (ii) autori i referohet vetes me komandant i “njësisë speciale”; dhe (iii) disa shënime në Ditar konfirmohen dhe përputhen me prova të tjera në dokumentacionin gjyqësor.

4. Ndonëse autenticiteti i dokumentit, për mendimin tim, nuk ka nevojë të vërtetohet në këtë fazë, pajtohem me Shumicën se autenticiteti *ex facie* mund të merret parasysh gjatë shqyrtimit të besueshmërisë *prima facie* të materialit të paraqitur si provë. Megjithatë, për mendimin tim modest, kur konkludoi se Ditari nuk është *ex facie* autentik, Shumica në të vërtetë zbatoi një standard më të lartë – atë të vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm – në lidhje me autenticitetin e Ditarit, dhe jo standardin e lartpërmendur. Për më tepër, çështja e autenticitetit nuk lidhet vetëm me autorësinë e

¹ Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave sipas Rregullës 92ter, lëshuar konfidencialisht më 23 gusht 2011; Arsyetim i Vendimit për mospranimin si provë të dokumentit të rregullës 65ter numër 03003, lëshuar publikisht më 6 tetor 2011 (“Vendimi i Shumicës”).

² Vendimi i Shumicës, f. 6.

Ditarit apo burimin e informacionit të paraqitur në të, e aq më pak me “mënyrën e komunikimit midis burimit dhe autorit”.

5. Në të shkuarën Tribunali ka pranuar ditarë dhe fletore të shkruara me dorë të personave të akuzuar dhe ka zbatuar kritere të ndryshme për verifikimin e autenticitetit të tyre. Standardi që zbatoi Shumica kur refuzoi pranimin e Ditarit si provë nuk përputhet me jurisprudencën e Tribunalit në përgjithësi ku Dhomat Gjyqësore janë mbështetur në prova shoqëruese, si për shembull dëshmi të ekspertëve të dorëshkrimit,³ apo të ndonjë bashkëpunëtori të ngushtë të autorit,⁴ dhe kanë marrë parasysh vendin dhe autoritetin përgjegjës për konfiskimin e materialit.⁵ Me sa duket, Vendimi i Shumicës e vendos Ditarin – rrëfim i disa ngjarjeve i shkruar me dorë, i cili supozohet se i takon njërit prej të akuzuarve në këtë çështje - në një kategori të veçantë, disi ndryshe nga provat e tjera dokumentare që bazohen në burime të panjohura të informacionit apo në informacion të dorës së dytë (raporte zbulimi apo artikuj shtypi), apo autori i të cilave është i panjohur apo i paverifikuar (përgjime, duke përfshirë përgjime që pretendohet se përmbajnë zërin e njërit prej të akuzuarve),⁶ por që prapëseprapë janë pranuar si prova materiale në jurisprudencën e Tribunalit.

6. Duke marrë parasysh vlerën e mundshme provuese të Ditarit, Dhoma duhej të shqyrtonte mundësinë që, në interes të drejtësisë t’i lejonte Prokurorisë që nëpërmjet paraqitjes së provave të tjera shoqëruese të zgjidhte mospërputhjet në lidhje me referimin që i bëhet Balajt në vetën e parë dhe të tretë, apo në lidhje me dorëshkrimet në dukje të ndryshme. Në përputhje me Rregullën 89(C), unë do ta urdhëroja Prokurorinë të paraqiste

³ *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-T, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për rihapjen e çështjes, 6 tetor 2010, para. 46-50.

⁴ *Prokurori k. Stanishiqit dhe Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-T, Urdhër drejtuar Prokurorisë për përzgjedhjen e pjesëve përkatëse të Fletoreve të Mlladiqit dhe për përkthimin e tyre në anglisht, 29 qershor 2010, f. 4; *Prokurori k. Stanishiqit dhe Simatoviqit*, Lënda Nr. IT-03-69-T, Vendim mbi Kërkesën e gjashtëmbëdhjetë të Prokurorisë për leje për ndryshimin e listës së provave të Prokurorisë me Shtojcën konfidenciale (Fletoret e Mlladiqit), 7 tetor 2010, para. 13.

⁵ *Prokurori k. Stanishiqit dhe Simatoviqit*, Lënda Nr. IT-03-69-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e pjesëve të Fletoreve të Mlladiqit dhe Njoftimin e dytë të Prokurorisë në lidhje me pjesët e Fletoreve të Mlladiqit, 10 mars 2011, para. 12.

⁶ *Prokurori k. Vujadin Popoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-88-T, Vendim mbi kushtet e pranimin të përgjimeve, 7 dhjetor 2007, para. 32; *Prokurori k. Stanishiqit dhe Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-T, Vendim për refuzimin e Mocionit të Stanishiqit në lidhje me mospërfshirjen e përgjimeve të regjistruara, 16 dhjetor 2009, para. 18-19.

dëshminë e ndonjë dëshmitari të kualifikuar sipas Rregullës 94bis për t'i qartësuar dorëshkrimet në dukje të ndryshme në Ditar, për ta ndihmuar Dhomën në marrjen e vendimit miratues në lidhje me vlerën provuese të mundshme të Ditarit.

7. Për arsyet e lartpërmendura, jam i mendimit se rishikimi i Vendimit të Shumicës është i përligjur për parandalimin e një padrejtësie që i privon si Prokurorinë, po ashtu edhe Dhomën prej një prove me gjasë të rëndësishme që ka lidhje dhe vlerë provuese për çështjet e kundërshtuara nga palët.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi Guy Delvoie

Sot, më datën 27 shkurt 2012.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]